



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.57/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Ex-Fis” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizim e përfaqëson Atdhe Dika avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik, të mbajtur me datë 15.04.2024 në prani të përfaqësuesit të paditësit avokat Atdhe Dika, dhe në mungesë të përfaqësueses së paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 15.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit “Ex-Fis” Sh.P.K., me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET pjesërisht vendimi nr.244/2017 i datës 17.08.2017 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës e që i referohet njoftim rivlerësimeve të qarkullimit shtesë për sasinë prej 169,095.00 litra kerozinë në vlerë prej 116,574.74 euro, në emër të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, për periudhën tatimore 2015.
- III. DETYROHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës që paditësin “Ex-Fis” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ta liroj nga qarkullimi shtesë për sasinë prej 169,095.00 litra kerozinë në vlerë prej 116,574.74 euro, në emër të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, për periudhën tatimore 2015.
- IV. DETYROHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Ex-Fis” SH.P.K, me seli në Prishtinë, t’ia kthej mjetet e paguara më tepër në emër të ngarkesës shtesë për TVSH shumë prej 20,983.00 euro, në emër të tatimit shtesë në korporata shumë prej 11,657.50 euro dhe në emër të ndëshkimit prej 25 % shumë prej 8,160.12 euro, respektivisht shumë e tërësishme prej 14,800.62 euro, te gjitha këto së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e

Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

V. MBETET NË FUQI vendimi nr.244/2017 i datës 17.08.2017 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, në pjesën jokontestuese.

VI. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Dhoma e shkallës së dytë të kësaj gjykate me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 227/22 të datës 18.01.2024, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit “Ex-Fis” Sh.P.K., me seli në Prishtinë dhe ankesën e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, e ka prishë Aktgjykimin A.nr.1564/17 të datës 29.04.2021 të Divizionit Fiskal të Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe lënda i është kthyer kësaj gjykate në rigjykim dhe rivendosje.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit me padi, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës ATK-së, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.244/2017 i datës 17.08.2017, i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.04.2024 dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbasin në tërësi pranë kërkesës së precizuar gjatë shqyrtimit të kësaj çështje si në seancën e datës 29.04.2021, për më tepër duke respektuar udhëzimet nga Dhomat e Shkallës së Dytë ka propozuar që eksperti prezent në këtë seancë të jap sqarimet e tij sipas udhëzimeve respektivisht kërkesës të dhënë të Dhomës të Shkallës së Dytë të prezantuar si në aktvendimin e lartcekur. Gjykatës i ka propozuar që përmes aktgjykimit të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar ta anuloj aktvendimin nr.244/2017 të datë 17.08.2017, duke e detyruar të paditurën që paditësin ta liroj nga qarkullimi shtesë për sasinë prej 169,095.00 litra kerozinë në vlerën financiare prej 116,574.74 euro në emër të TVSH-së dhe të Tatimit në të Ardhurat e Korporatave për periudhën e vitit 2015 ashtu që duke e detyruar të njëjtën që pas anulimi të vendimi të lartcekur t’ia kompensoj paditësit në emër të ngarkesës shtesë për TVSH shumën prej 20,983.00 euro në emër të tatimit shtesë në korporata shumën prej 11,657.50 euro dhe në emër të ndëshkimit prej 25 % vlerën prej 8,160.12 euro respektivisht shumën e tërësishme prej

14,800.62 euro si dhe me kamatë ligjore 8% në vit duke filluar nga data 14.09.2017 deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,950.00 euro dhe atë për përfaqësim në pesë seanca gjyqësore secila nga 270 euro dhe ekspertiza financiare prej 600 euro.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 13.12.2018 e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se bazuar në shkresat e lëndës dhe verifikimeve nga ana e Departamentit të Ankesave është konstatuar se trajtimi si shitje shtesë nga kontrolli për mungesat e konstatuara në stoqe të artikujve Kerozinë dhe Linjit është i bazuar në dispozitat e nenit 18 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 për Zbatimin e Ligjit nr.03/L-222 dhe nenin 11 të Ligjit 05-L-037 për TVSH-në. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.04.2024 për të paditurën nuk ka prezantuar askush, ndërsa me parashtrësën e datës 05.04.2024 e paditura ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë, me kërkesë që Gjykata të veproj në pajtim me neni 38 paragrafi 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ. Më tej ka deklaruar se mbeten në tërësi pran përgjigjes në padi dhe gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj padinë/ankesën e paditësit në tërësi si të pabazuar dhe ta lë në fuqi vendimin nr.244/2017 të datës 17.08.2017.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik, ka administruar provat relevante dhe atë: Procesverbali i datës 21.10.2020, 29.04.2021, Parashtrësia në ekspertizën financiare e datës 31.03.2020, Përgjigjet në ekspertizën financiare nga ATK, Përgjigje në padi e datës 13.12.2018, Vendimi nr.244/2017, i datës 17.08.2017, i ATK-së, Raporti i kontrollit i datës 12.06.2017, Ankesa ndaj Raportit të Kontrollit, datës 05.07.2017, nr.244/2017, Libri i Blerjeve dhe Importeve në Depon Doganore, Kërkesa për Anulimin e DUD-ve, Libri i Blerjeve, Pasqyra e shkarkimeve më X3, Forma e Pranim-Dorëzimit të Draft Raportit të Kontrollit, Procedura e Ankesës, dt.13.06.2017, nga ATK-ja, Ankesa e paditësit ndaj Raportit të kontrollit, datës 12.06.2017, Kërkesa për anulimin e DUD-ve, dt.04.12.2015, Deklarata e detajuar, e dt.26.02.2016, Deklaratat Doganore, Rivlerësimi për Tatim në Korporata, i dt.31.03.2016, Forma për Vizitat Përbushëse e datës 14.03.2016, nga ATK-ja, Gjendja e Borxheve, e datës 14.08.2017, nga ATK-ja, Vendimi Shpjegues Publik nr.03/2014, Libri i blerjes, Ekspertiza financiare, e datës 31.03.2020, Plotësimet e Ekspertizës financiare, të datës 08.02.2021 dhe 12.04.2021.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave të palëve ndërgjyqëse, dhe pasi vlerësoi provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, Gjykata nga Raport Kontrolli i ATK-së, deklarimeve në ankesë, si dhe aktvendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se në bazë të Raportit të kontrollit, për periudhën TVSH 09/2014-12/2015, CD 12/2014-12/2015, WM 09/2014-12/2015, CM 09/2014-12/2015 dhe WR 09/2014-12/2015, si rezultat i kontrollit ka pasur rritje të qarkullimit dhe mos pranim i shpenzimeve nga e paditura.

Me vendimin kontestues, e paditura Departamenti i ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës e ka aprovuar pjesërisht ankesën e tatimpaguesit, këtu paditësit dhe ka korrigjuar pjesërisht Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë TVSH 12/2015 dhe CD/2015, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar dhe obligim pagesa për tatimpaguesin.

Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.644/22 të datës 18.01.2024, ka kthyer lëndën në rivendosje kësaj gjykate me arsyetimin se në dispozitiv është aprovuar pjesërisht padia e paditësit, mirëpo nuk është sqaruar se cila pjesë është refuzuar dhe cila pjesë e vendimit kontestuese ka mbetur në fuqi. Lidhur me kërkesën e paditësit për detyrimet e paguara e njëjta kërkesë duhet të jetë e përcaktuar saktë në vlerë monetare nga pala paditëse e kur nuk është e mundur të caktohet ekspertiza financiare. Po ashtu ka udhëzuar gjykatën që të ftoj ekspertin për të dhënë sqarime në ekspertizë në drejtim të asaj se a është marr parasysh fati se ATK me rastin e vizitës së kryer të subjekti tatimor a i ka larguar nga vlerësimi DUD-at e anuluar me IM& dhe a i ka pranuar DUD-at e shndërruar në IM4, respektivisht të jep sqarime nëse ATK ka llogaritur DUD-at IM4 për sasinë e kerozinës së importuar nga paditësi.

Eksperti financiar në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.04.2024 ka deklaruar se *“Ashtu siç jam deklaruar edhe gjatë seancave të mbajtura gjatë hartimit të ekspertizës bazë, hartimi të plotësimin të ekspertizës bazë në dy raste, në të cilat konsideroj se janë dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme lidhur me këto kërkesa që janë të paraqitura nga ana e shkallës së dytë të kësaj gjykate. Duke pasur parasysh se në plotësimin e ekspertizës të datës 12.04.2021 me numër 047/2021 konsideroj se për këtë periudhë kohore kontestuese të përlogaritura nga ana e ATK-së në plotësim të ekspertizës janë dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme sa i përket*

pjesës të shkarkimeve të cilat janë kryer në vitin 2016, por që të njëjtat ATK i ka përfshirë në vitin 2015. Andaj mendimi im ka qenë dhe është prapë se malli i cili i është nënshtruar procedurës nga depoja doganore duke kaluar nga DUD-a IM7 të njëjtat kanë qenë stoqe të subjektit në fund të vitit 2015, ndërsa ATK në fund të vitit 2015 këtë sasi prej 658, 753 litra e ka shkarkuar e ka trajtuar si shitje të vitit 2015 , ndërsa Dogana e Kosovës dhe subjekti këtë shkarkim të këtij malli e ka bërë përmes proceduarave doganore IM4 dhe EX3 nga depot doganore në shitje të lirë në vitin 2016 për çka është e vërtetuar edhe përmes dokumenteve të cilat janë të bashkangjitura në shkresa të lëndës. Mbi këtë bazë konsideroj se nga ana e ATK-së – kontrolli dhe e njëjta është vërtetuar me vendimin kontestues që paraqet shitje të dyfishtë. Nga faqja tre deri në faqen 8 të të plotësimit të ekspertizës janë të sqaruara në mënyrë tabelare, nga kjo rrjedhë se ky mall kontestues nuk duhet ti nënshtrohet përlllogaritjes së TVSH dhe taksave doganore në procedurën e doganimit sepse është mall i llojit kerozinë e cila përdoret ekskluzivisht për aeroplan dhe helikopter (të njëjtat e përdor Nato dhe kompanitë ndërkombëtare që kryejnë fluturime ndërkombëtare të listuara në faqen dy deri në faqen tetë).”

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të datës 31.03.2020, plotësimin e saj të datës 08.02.2021 dhe 12.04.2021 të ekspertit financiar V.I. dhe deklaratën e tij në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.04.2024 në tërësi si të besueshme, meqë të njëjtat ishin profesionale, të mbështetura në bazë të mjaftueshme ligjore, i njëjti ka konstatuar drejtë gjendjen faktike bazuar në prova dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Gjykata konstaton se e paditura nuk i ka mbështetur në prova materiale konstatimet e saj se paditësi ka pasur mungesë në stoqe të artikullit kerozinë në sasi prej 169,095 litra për periudhën tatimore 2015, pasi që nga analiza materiale që ka bërë kontrolli nga importet gjegjësisht shkarkimet, gjatë periudhës 2015, nuk është marr për bazë e gjithë sasia e regjistruar në këtë periudhë tatimore, dhe nuk janë përfshirë të gjitha shkarkimet e këtij artikulli kerozinë, të cilat kanë ndodhur nga regjimi doganor IM-7 në depon doganore, dhe janë shkarkuar me regjim IM-4 dhe EX-3 në periudha 2015 dhe 2016.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore.

Rrjedhimisht, Gjykata nuk i konsideron të mjaftueshme konstatimet e të paditurës se ka mungesa në stoqe, nga krahasimi që është bërë nga regjistrimet-stoqet e sasisë së artikullit

kerozin dhe regjistrimeve nga ana e paditësit. Nga të gjitha këto prova të administruara, Gjykata ia fali besimin në tërësi mendimit profesional të Plotësimit të ekspertizës financiare dt.12.04.2021, përmes së cilës janë siguruar provat materiale se për artikullin kerozin janë shkarkuar importet me regjimin doganor IM-4 dhe EX-3 në periudhën 2015 dhe 2016, të cilat i janë bashkangjitur plotësimit të ekspertizës financiare. Në plotësimin e ekspertizës financiare dt.12.04.2021, eksperti financiar ka përshkruar në formë tabelare të gjithë DUD-at IM-7 për sasinë e mallit kerozinë që gjendet në stok depo doganore, e që i përkasin muajit dhjetor 2015, dhe shkarkimet me IM-4 dhe EX-3 gjatë periudhës 2015 dhe 2016, e cila sasi ka dal në qarkullim të lirë sipas shkarkimeve të procedurave doganore, ndërsa në seancën gjyqësore eksperti financiar i ka deklaruar gjykatës, se sipas dokumenteve që burojnë gjatë verifikimit të IM-7 dhe IM-4, EX-3, sasia e artikullit kerozin prej 658,753 litra, janë shkarkuar gjatë viti 2016, sipas Dokumenteve Unike Doganore të pakontestuar.

Gjykata duke konstatuar se qarkullimi shtesë për sasinë e artikullit kerozinë, është vendos pa bazë nga kontrolli tatimor, e aprovoi Kërkesëpadinë e paditësit, anuloi pjesërisht Vendimin nr.244/2017 të datës 17.08.2017 të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Meqenëse me të njëjtin pjesërisht ishte aprovuar ankesa e tatimpaguesit këtu paditësit dhe meqenëse në këtë konflikt administrativ paditësi fare nuk e ka kontestuar qarkullimin shtesë nga mungesa e artikullit linjit si mungesë në stoqe në vitin 2014 që ka rezultuar nga kontrolli, dhe nuk ka provuar ndonjë provë materiale të rëndësishme para gjykatës, që do ti ndryshonte vlerësimet e të paditurës në trajtimin e artikullit linjit si shitje, atëherë gjykata nuk ka gjykuar këtë vlerësim të konstatuar nga e paditura, dhe të njëjtin vlerësim e ka lënë në fuqi.

Gjykata obligon të paditurën Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditësin, ta liroj nga qarkullimi shtesë për sasinë prej 169,095.00 litra kerozinë në vlerë financiare prej 116,574.74 €, në emër të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, për periudhën tatimore 2015. Mbesin në fuqi vlerësimet tjera të caktuara, sipas Njoftim Rivlerësimeve të lëshuara nga ATK-ja, Drejtoria e DTM-së Prishtinë, dhe Vendimit nr.244/2017 i datës 17.08.2017 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, në pjesën jo kontestuese.

Me nenin 46 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, përcaktohet se *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do*

të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore “.

Prandaj, Gjykata duke vepruar konform nenit 43, par 3 dhe 46 par. 3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, anuloi vendimin kontestues dhe e detyroj të paditurën Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Ex-Fis” SH.P.K, ta liroj nga qarkullimi shtesë për sasinë prej 169,095.00 litra kero1zinë në vlerë prej 116,574.74 euro, në emër të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, për periudhën tatimore 2015. Po ashtu gjykata e detyroi të paditurën që paditësit t’ia kthej mjetet e paguara me tepër në emër të ngarkesës shtesë për TVSH shumën prej 20,983.00 euro, në emër të tatimit shtesë në korporata shumën prej 11,657.50 euro dhe në emër të ndëshkimit prej 25 % shumën prej 8,160.12 euro, respektivisht shumën e tërësishme prej 14,800.62 euro, të gjitha këto së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve.

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi në emër të ngarkesës shtesë për TVSH shumën prej 20,983.00 euro, në emër të tatimit shtesë në korporata shumën prej 11,657.50 euro dhe në emër të ndëshkimit prej 25 % shumën prej 8,160.12 euro, respektivisht shumën e tërësishme prej 14,800.62 euro u konstatua nga plotësimi i ekspertizës financiare e datës 08.02.2021, të punuar nga eksperti financiar V.I..

Në lidhje me kumatën, gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimit bazuar në dispozitën e nenit 57.4 të Ligjit nr.2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me të cilin përcaktohet se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t’i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”* dhe nenin 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është përcaktuar se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është*

zgjdhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj 10 kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

Gjykata i pati parasysh edhe deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi si dhe kundërshtimet lidhur me ekspertizën e punuar nga eksperti financiar, mirëpo gjeti se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative. Kjo për faktin se paditësi pretendimet e veta siç u vlerësuar edhe më lartë i ka të bazuara në dokumentet të besueshme të konstatuara si të tilla edhe me ekspertizën financiare dhe plotësim ekspertizat financiare të administruara si prova nga gjykata dhe të cilat nuk ka mundur ti kundërshtoj as e paditura me ndonjë provë materiale.

Gjykata, vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, e ka marr konform nenit 64 të LKA-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata konform nenit 43 par.2, dhe 46 par 1, 2 dhe 5, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv , këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.57/24, datë 15.04.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.